



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 196, datë 29.12.2025

PËR
MIRATIMIN E EMËRIMIT TË ANËTARIT TË KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT
DHE ZËVENDËSADMINISTRATORIT TË SHOQËRISË “RAIFFEISEN INVEST -
SHOQËRI ADMINISTRUESE E FONDEVE TË PENSIONIT PRIVAT DHE
SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 15 dhe 17, të Ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”, neneve 14 dhe 15 të Ligjit nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, Rregullores nr. 112, datë 31.08.2020 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Rregullores nr. 1, datë 31.01.2024, “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat dhe depozitarit të fondeve të pensionit privat të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e emërimit të zj. Elsa Kristo, në pozicionin e anëtarit të Këshillit të Administrimit dhe Zëvendësadministratorit të Përgjithshëm të shoqërisë “Raiffeisen INVEST - shoqëri administruese e fondeve të pensionit privat dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive” sh.a., për një periudhë 3 vjeçare, deri më datë 22.10.2028.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Saimir TOLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Adela XHEMALI